

SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të përgjithshme

Bashkia ka si qëllim ofrimin e shërbimit të Pastrimit në të gjithë territorin e saj aktual me standarte dhe performancë të lartë, duke siguruar reduktimin e impakteve negative të mbetjeve në shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit.

- Kompania private duhet të kryejë grumbullimin dhe transportin e mbeturinave të prodhuara.
- Është parashikuar që në Bashkinë Vorë cdo ditë prodhohen respektivisht rreth **39 ton/dite** mbetje urbane .
- Gjithashtu kompania duhet të kryejë edhe zera të tjera shërbimi të detajuara si më poshtë sipas dhe preventivit të shërbimit.

Llogaria e koston për shërbimin e Pastrimit është bërë sipas modelit “Për miratimin e masave për koston e menaxhimit të integruar të mbetjeve” miratuar me VKM nr.319 date 31.05.2018.

Ketu përfshihen të gjitha elementet e këtij shërbimi, të ndara në 6 blloqe përllogaritjeje.

1-Të dhëna të përgjithshme për njësinë administrative.

2-Investimet kapitale.

3-Kostot operative (mirëmbajtje, transport dhe personel).

4-Kostot e amortizimit(ri-investimit).

5-Kostot administrative.

6-Përllogaritja e kostove totale të shërbimit.

Pra, blloku 6, paraqet kapacitetin e nevojshëm financiar për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve.

Për ta lehtësuar paraqitjen në preventiv të kësaj kostoje, përllogaritjet sipas modelit të mesiperm, sipas VKM i bëjmë pa përfshirë vlerën e TVSH .

Kjo edhe për arsyen tjetër, pasi kemi dhe procese të tjera shërbimi për pastrimin, jashtë këtij modeli përllogaritjeje, të cilat në analizat e cmimit nuk kanë përfshirë vlerën e TVSH . Sipas legjislacionit, vlerën e TVSH e paraqesim në fund vlerës së preventivit .

Proceset e punës jashtë kësaj metodologjie janë: Dizefektimi i Konteniereve, fshirja manuale, larje rrugësh ditën dhe natën, mirëmbajtje e PGM-ve.

Bashkëlidhur të dhënat në specifikimet teknike si më poshtë.

1 Grumbullimi i Mbetjeve

1.1 Volumet e punimeve

Bashkia Vore ka një popullsi prej 39 069 banorë

Zona ka karakter urban.

Në total në zone gjenerohen afërsisht rreth **39 ton/ditë** mbetje të urbane, ose **14, 235 ton** mbetje të urbane gjatë gjithë viti, të cilat duhet të grumbullohen dhe transportohen në

landfillin e Sharres çdo ditë të javës. Parashikimi i volumeve ka marrë në konsideratë përveç koeficientit për banor edhe zbatimin e Planit Lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane për Bashkinë Vore.

Kjo sasi mbetjesh do të mbledhet në terren nga **334** kontenierë me kapacitet 1,100 litra (1.1m³) të shtrirë në të gjithë njësinë administrative.

1.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i grumbullimit, të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

- a.**Zbrazjen e kontenierëve me makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar.
- b.** Mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 5 m nga çdo kontenier.
- c.**Pastrimin dhe fshirjen me fshesë të sipërfaqes prej 30 m² rreth çdo pike grumbullimi.
- d.**Rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur.
- e.**Klorifikimi i zonës së kazanëve, sipas normativave.
- f.**Larjen e kazaneve sipas grafikeve të miratuara.

1.3 Frekuencat e grumbullimit

- a.** Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve do të ofrohet çdo ditë. Oraret e grumbullimit do të jenë natën, nga ora 20.00 deri në orën 06.00.
- b.**Mbetjet do të grumbullohen 1 herë në ditë. Pra firma sipërmarrëse do përpunojë **334** kazane në ditë.

1.4 Plani i vendosjes së kontenierëve dhe grafikët e punimeve

- a.**Autoriteti kontraktor ka përcaktuar pikat e saktë të grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane, dhe numrit të kontenierëve për secilën pikë, në të gjithë zonën ku përfshihen edhe të gjitha pikat e grumbullimit .
- b.**Kontraktuesi është i detyruar të zbatojë planin fillestar të pikave. Ky plan mund të ndryshojë gjatë kohës së zbatimit të kontratës me propozim të kontraktuesit ose nga Autoriteti kontraktor sipas nevojave për përmirësimin e shërbimit dhe mirë organizimit të tij,ose si rezultat i ndryshimeve që mund të ndodhin në infrastrukturë gjithmonë pas kërkesës së njëres palë dhe bëhen të zbatueshme pas miratimit të Autoritetit kontraktor.
- c.**Autoritetit kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjopa për mospërbushjen e tyre.

1.5 Rregulla për tu zbatuar

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të patransportuara dhe mbeturina të lëna në zonen përreth kontenierëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, kontraktuesi duhet të njoftohet menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e kontraktuesit dhe do të vendosen penalitete.

b. Kontraktuesi ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së kontenierëve dhe përfshirjen në grafikun e punimeve.

c. Kontraktuesi duhet të ketë në efikasitet një “Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të kontraktuesit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktor dhe për t’u dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 1 ore nga marrja e njoftimit.

d. Kontraktuesi detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, pajisjeve.

e. Kontraktuesi detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

f. Në asnjë rast nuk duhet të kryhet largimi i mbeturinave urbane nga kontenierët në akset kryesore, para se të jetë kryer fshirja dhe pastrimi i rrugëve ku ndodhen. Në të kundërt operatori i shërbimit duhet kryejë përsëri zbrazjen e kontenierëve pa shpenzime ose duhet të përdorë mjete shtesë për të garantuar që kontenierët të jenë bosh pas përfundimit të të gjitha shërbimeve të pastrimit.

g. N.q.s gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballë me penalitetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjoba të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

i. Përdorimi i uniformave dhe masave të sigurimit teknik për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast moszbatimi aplikohen gjoba për mosplotësim këtij detyrimi.

1.6 Mjetet dhe pajisjet

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, (mbledhjes, transportit, largimit të mbeturinave) dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

Kërkesa për mjete.

Nr	Emertimi I mjetit	Kapaciteti	Sasi (cope)
1	Makina teknologjike pastrimi	Mbi 10 ton	2
2	Makine teknologjike pastrimi 3 deri 4 ton	3 deri 4 ton	1
3	Makine teknologjike pastrimi 0.5 deri 1.5 ton	0.5 deri 1.5 ton	1
4	Kamioncine 2 deri 4 ton, veteshkarkuese.	2 deri 4 ton	1
5	Makine teknologjike me paisje te vecante per larjen e konteniereve		1
6	Makine larje rruges me kapacitet mbajtes 7 deri 8 ton	7 deri 8 ton	1
7	Makine teknologjike pastrimi rezerve	10 ton	1

1-Mjet teknologjik pastrimi jo me pak se 10 ton. Sasia e mbeturinave qe grumbullohen ne dite eshte **39 ton** ose 4 rruge ne dite. Jane kerkuar 2 mjete te cilet punojne për të evaduar të gjithë sasinë e mbetjeve ditore.

2-Mjet teknologjik pastrimi 3 deri 4 ton dhe 0.5 deri 1.5 ton cope 2. Jane kerkuar per grumbullimin e mbeturinave ne rruge te ngushta (dere me dere) ku nuk ka mundesi te futet mjeti me kapacitet 10 ton.

3- Kamioncine 2 deri 4 ton, veteshkarkuese per mirembajtjen e VGM gjate dites dhe grumbullimi i mbetjeve ndertimore dhe te vellimshme.



4- Makine teknologjike me paisje te vecante per larjen e konteniereve. Ky mjet sherben per larjen e konteniervave ne vend pa u transportuar ne autopark. Paisja e vecante konsiston ne sprucatore te ujit dhe dizinfektantit si dhe Vasken e mbetjeve qe dalin nga larja e kontenierit.

5-Makine lagje dhe larje rruges cope 1. Siperfaqja e rruges qe do te laget ne vit **28068 m2 ne dite.**

6-Mjet teknologjik pastrimi reserve 10 ton. Ky mjet nevojitet per zevendesim ne rast se eshte me defekt ndonje mjet.

7-Ne llogaritjen e kostove operative (per mjetet) merret ne konsiderate kostoja e mirembajtjes se tyre.(siguracion, taksa, vaj, filtra, goma, mirmbajtje mekanike, parking)

Lloji i mjetit	Mjet teknologjik transportues (kompaktor)
----------------	---

Ngarkimi fundor i makinës (kapaciteti i mjetit)	10ton/5ton 
Raporti i Kompaktimit	1:4 – 1:6
Kapja e mjetit në pjesën fundore	Duhet të jetë me krahë kapës për kontenierë me volum 1100 litra (1.1m ³) 
Rrotat e mjetit	Duhet të jenë rrota të mëdha të cilat të mund të lëvizin
Marshi	Manual
Klasa e shkarkimit	Sipas legjisllacionit ne fuqi

- a.**Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më pak se **2 (dy) copë dhe nje rezerve.**
- b.**Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 3 deri 4 ton dhe 0.5 deri 1.5 ton , raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më pak nga **1 (nje) copë** per secilen.

1.7 Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:

a.Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.

b.Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuar nga Autoriteti kontraktor. Ato duhet të mbahen në gjëndje të pastër dhe të rregullt. Një pjesë e

konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të jenë gjendje për të siguruar plotësimin e gatishmërisë së mjeteve.

c.Mjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dezinfektohen çdo ditë pas përfundimit të punës.

d.Detyrimisht në të gjithë makinat duhet të shkruhen mesazhe për edukimin mjedisor, numër telefoni i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht po nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu në të gjitha mjetet përveç mbishkrimeve të mësipërme, duhet të prezantohen shpjegues të qartë për llojin e mbeturinave që mblidhen, si dhe orarin kur largohen mbeturinat.

1.8 Kushtet teknike për mjetet e transportit

a.Të gjitha mjetet e transportit duhet të jenë në gjendje të mirë teknike për të mundësuar grumbullimin e mbeturinave.

b.Makinat teknologjike duhet të kenë një sistem ngarkimi të përshtatshëm me kontenierët që përdoren në Bashkinë Vore.

c.Sistemi mekanik i ngarkimit duhet të jetë i gjithi funksional dhe të lejojë kryerjen e një cikli të plotë (ngritjen e kontenierit, shkarkimin dhe uljen e tij).

d.Sistemi mekanik i ngritjes duhet të funksionojë vete dhe nuk duhet që puntorët të ngrënë kontenierin për ta varur atë në këtë sistem.

e.Makinat teknologjike duhet të jetë në një gjendje të mirë, pa rrjedhje të ndonjë fluidi, dhe në gjendje të punojë 8 orë në ditë në mënyrë të vazhdueshme pa ndërprerje për arësye mekanike. Gjithashtu ato duhet të jetë i aftë për të lëvizur me një shpejtësi deri në 80 km/h.

f.Shkarkimet e gazërave të djegies nga makinat teknologjike duhet të jenë në përputhje me normat e legjislacionit në fuqi.

g.Dritat e përparme dhe të pasmet duhet të jenë në gjendje të mirë dhe makinat duhet të jetë gjithashtu të pajisur me reflektorë.

h.Makinat teknologjike duhet të jenë të pajisur me pasqyra të jashtme për të pasur një vision të qartë mbrapa, me mbajtëse/suport për puntorët, me sistem komunikimi (radio ose telefona) të cilat duhet të jenë të lidhura me qendrën e operimit.

i.Sistemi i ngjeshjes duhet të jetë në gjendje të mirë për të lejuar një shkallë të mirë ngjeshje për të realizuar ngarkimin e sasisë së kërkuar të mbeturinave brenda volumit të kamionit (respektivisht 10 dhe 5 ton)

j.Kontraktuesi duhet të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e makinave teknologjike dhe për faktin që ata duhet të jenë të gjithë në gjendje pune.

k.Në qoftë se një makinë është jashtë shërbimit, kontraktuesi duhet ta zëvendësojë atë me shpenzimet e tij me një makinë të ngjashme me të përgjatë gjithë kohës së riparimit të saj. Të tilla situata nuk duhet të kenë ndonjë influence apo ndikim mbi sasinë dhe cilesinë e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve.

l.Makinat teknologjike duhet të lahen çdo ditë dhe të tregohet kujdes për to. Ato duhet të sigurojnë një grumbullim të sigurt, të pastër dhe higjienik të mbetjeve.

m.Në qoftë se makinat teknologjike nuk do të plotësojnë këto kërkesa, si pasojë e neglizhencës në mirëmbajtje nga kompania, atëherë autoriteti kontraktor do të kërkojnë zëvendësimin e tyre.

1.9 Personeli

a. Personeli i nevojshëm për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave është një shofer dhe tre puntorë për çdo makinë që grumbullon dhe transporton mbetjet.

b. Kushtet e punës për të gjithë stafin duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kështu stafi duhet të jetë i paisur me rrobat e përshtatshme të punës, me shenja dalluese që do të bëjnë të mundur identifikimin e tyre dhe gjatë natës, me doreza dhe paisje të tjera mbrojtëse për sigurimin teknik në punë.

- Kerkesa per puntori

Nr	Specialiteti	Njesi	Sasi
1	Shofere	persona	5
2	Puntor makine per grumbullim mbeturina	persona	16
3	Puntor per fshirje manuale	persona	14
4	Shofer per larjen dhe dizinfektimin e konteniereve	persona	1
5	Punetore per larjen dhe dizinfektimin e konteniereve	persona	2
6	Drejtor teknik per kontraten	persona	1
7	Shofer per larjen e rrugeve	persona	1
8	Personi i zyres se kontaktit	persona	1
9	Specialist, monitorues terreni	persona	2
	Shuma		43

1-Shoferi persona 4(Kater). Meqe ne specifikime kemi kerkuar nga 4 mjete transporti pra duhen **4 shoferi**, plus nje shofer per kamioncinen e cila miremban VGM ne total duhen 5 shoferi.

2-Puntor makine per grumbullim mbeturina persona 12 (dymbedhete). Ne normativat e mjeteve te transportit çdo mjete inevojiten 3 punetore qe bejne vendosjen e kontenierit ne mjet pastrimin e vendit dhe shkarkimin e mbeturinave ne mjet. Meqe jane kerkuar 4 mjete numri i puntoreve qe duhen eshte 12 (dymbedhete). i shtojme edhe 4 punetore te kamioncines ne total dote duhen 16 punetore.

3-Punetore per fshirje manuale jane kerkuar 14 (katermbedhjet).

4- Puntor per Mirembajtja e VGM gjate dites dhe grumbullimi i mbetjeve ndertimore dhe te vellimshme. Nje shofer per kamioncinen dhe 4 punetore

5- Shofer per mjetin e Larjes se Kazaneve 1 (nje)

6-Punetore per larjen dhe dizinfektimin e konteniereve 2 (dy)

7-Shofer per mjetin e larjes se rrugeve 1 (nje)

8-Personi i zyres se kontaktit, monitoruesit e terrenit jane persona pjese te stafit te kontraktorit qe bazuar ne specifikimet teknike do sherbejne ne zyren per mardheniet per publikun si dhe do te monitorojne per llogari te kontraktorit dhe do te sherbejne edhe si pike kontakti zbatimin ne terren te kontrates.

Specialist , monitorues terreni, Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë dhe Drejtor teknik per kontraten.

2 Transportimi i Mbetjeve

Shërbimi i Transportit të mbetjeve urbane konsiston në :

- Grumbullimin e mbetjeve urbane ne pikat e depozitimit te mbetjeve (kontanier)

2.1 Inteneraret e grumbullimit

Eshte parashikuar qe per te evaduar te gjithë sasine ditore te mbetjeve do realizohen mesatarisht 4 rruge mjetesh te cilat me nje ngarkese te mbartur 8.5-9 ton arrijne te evadojne komplet sasine ditore prej **39** tonesh.

Frekuenca eshte 4 rruge (naten) dhe 2 rruge turni dyte, mbasdreke.

Koha mesatare per nje ngarkese te plote te mjetit eshte 4 ore.

Por, ne funksion te kerkeses se autoritetit kontraktor, per nje performance me te mire qe te realizohet evadimi i mbetjeve dy here ne dite, koha e mesatarizuar e nje ngarkimi te plote te mjetit nga 4 ore behet 4.3 ore.

Kjo per dy arsye:

1-Ne turnin e dyte (dreka) ka me shume shume trafik dhe veshtirson levizjen e mjetit dhe zgjat kohën e shërbimit.

2-Mjetit i takon te perpujtoje me shume kazane se normalja , meqe ne kete kohe(dreke) jo te gjithë kazanet jane te mbushur plotesisht.

Pra ne llogaritje kemi marre kohën 4.3 ore per ngarkim mjeti.

- Intenerari i mbushjes me mbetje te mjetit 2-5 tonesh , ne rruget e ngushta.

2.2 Rregulla për tu zbatuar

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen mjete teknologjike pastrimi te shkojne per depozitim mbetjesh ne Landfill, pa ngarkesen e plote te kalkuluar, minimumi 8.5 ton.

3. Dezifektimi i Kontenierve dhe PGM

3.1 Volumet e punimeve

- a. Operatori i shërbimit do të lajë dhe dezifektojë me Automjetin teknologjik 334 kontenierë në muaj ose mesatarisht 11 kontenierë/ditë, sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor.
- b. Duhet të bëhet dezifektimi i zonës përreth kontenierëve, pas zbrazjes së çdo kontenieri, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, duke përdorur sistemin e dezifektimit që duhet ta ketë çdo makinë teknologjike, duke përdorur të tretur lëndën e pluhurit të gëlqeres me 5% përmbajtje klori.

4. Menaxhim dhe mirembajtja kontenieresh.

Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për ruajtjen, menaxhimin, mirëmbajtjen dhe zëvendësimin e tyre.

4.1 Menaxhimi i kontenierëve:

a.Vendosja e kontenierëve do të përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor. Gjatë zbatimit të kontratës, kontraktuesi mund të zhvendosin kontenierë (duke ruajtur numrin rendor të tyre)

në sajë të një kërkesë fillestare të bërë dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktor. Të gjitha lëvizjet e konteneirëve janë të përfshirë në çmimin e kontratës. Kontraktuesi duhet të ketë një mjet që do të mundësojë zhvendosjen e konteneirëve.

b.Kontenierët do të identifikohen me një numër rendor, që do të mundësojë identifikimin i tyre nga grupi i monitorimit në Bashki. Kontraktuesi duhet të mbajnë një databazë me të gjithë kontenierët.

4.2 Mirëmbajtja e kontenierëve :

a.Kontenierët e dëmtuar duhet të rregullohen sistematikisht nga kontraktuesi. Kontraktuesi kanë për detyrë të monitorojnë rregullisht gjendjen fizike të kontenierëve, dhe të mbajnë një inventar për të gjithë kontenierët, të cilin duhet ta raportojë te Autoriteti Kontraktues. Në këtë inventar kontraktuesi duhet të japin sugjerimet në rast të nevojës për zëvendësim të kontenierëve, atëherë kur është e nevojshme. Për të riparuar kontenierët, kontraktuesi duhet të ketë një mjet të veçantë për transportin e kontenierëve për t'i riparuar ato në ambientet e kompanisë.

b.Kontraktuesi duhet të mbajnë një rezervë prej 10 (dhjete) kontenierësh, të cilët do të përdoren në emergjencë për zëvendësimin e atyre të cilët do të shkojnë për riparim.

c. Konkretisht operatori duhet të kryejë këto shërbime mirëmbajtje për kontenierët brenda 5 ditëve të evidentimit :

- Lyerja e kontenierit ;
- Ndërrimi i rrotave dhe dorezave ;
- Riparimi i kapakut dhe deformime të ndryshme të kontenierit;
- Zëvendësimi.

d.Përsa kohë kontenierët janë projektuar për një përdorim intensiv, ata nuk duhet të kenë nevojë për riparime nëse ato trajtohen ashtu siç duhet gjatë procesit të grumbullimit të mbetjeve. Pas grumbullimit kontenierët duhet të vendosen në pozicionin e tyre të mëparshëm.

e.Kontraktuesi duhet të kenë në dispozicion materialet dhe stafin e përshtatshëm për të realizuar këtë shërbim si dhe një ofiçinë të pajisur me mjetet dhe paisjet e nevojshme.

4.3 Larja e kontenierëve

Operatori i shërbimit do të lajë dhe dezinfektojë **334** kontenierë të volumeve 1.1 m³/ brenda muajit ose mesatarisht 11 kontenierë/ditë, sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor.

• Metodologjia

1. Operatori i shërbimit çdo natë sipas grafikut të miratur do përcaktojë kontenierët të cilët do të lahen dhe dizinfektohen. Automjeti i cili shërben për larjen e kontenierëve do të ndjeke makinën e grumbullimit të mbetjeve, pasi kjo makinë të ketë përfunduar procesin e makinës së larjes do të kryejë shërbimin e larjes së kontenierit. Paisja e veçantë konsiston në sprucatore

te ujit dhe dezinfektantit si dhe Vasken e mbetjeve qe dalin nga larja e kontenierit. Kontenierët për mbledhjen e mbeturinave urbane detyrimisht lahen nga brenda dhe nga jashtë.

2. Me shërbim dezinfektimi kuptojmë realizimin shërbimit të dezinfektimit të të gjithë sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme të kontenierit.

- **Grafikët e punimeve**

1. Grafikët e punimeve për, larjen e kontenierëve, përgatiten nga Kontraktuesi dhe miratohen nga Autoriteti kontraktor.

2. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga Kontraktuesi.

3. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

- **Mjetet dhe pajisjet**

1. Makine teknologjike me paisje te vecante per larjen e konteniereve, për të mundësuar larjen pa sjellë dëmtimin e tyre, jo më pak se **1 (një) copë**.

2. Lëndë dezinfektuese për dezinfektimin e kontenierëve.

5. Fshirja e manuale e rrugëve

5.1 Volumet e Punimeve

Autoriteti kontraktor ka parashikuar për fshirjen manuale sheshet, rrugët, trotuaret dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar, sipas hartes se rrugeve dhe grafikeve te miratuar nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e shërbimeve publike.

Operatori i shërbimit do të fshijë me krahë dhe do të kryejë të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse parashikuar në metodologji për të gjitha rrugët dhe trotuaret e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej **65 910 m²/dite**, volum pune qe kryhet nga **9** fshesatare, per ditet normale te punes dhe plus **5** fshesatare per zevendesim ne dite festash, fundjave dhe pushimesh. Pune qe do kryhet sipas frekuencave dhe grafikut të miratuar nga Autoriteti Kontraktor. Frekuencat e fshirjes përcaktohen në grafikun e listës së rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes.

5.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe trotuareve me krahë konsiston në:

- a. Fshirjen me punëtorë me fshesë të rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore të kategorive I, II, si edhe trotuarëve duke mbuluar sipërfaqet dhe gjatësisë lineare sipas garfikut përcaktuar me frekuencat dhe sipërfaqet të miratuara nga Autoriteti Kontraktor .
- b. Fshirjen dhe pastrimin me punëtorë pastrimi të gjitha segmenteve të zëna nga parkimi, trotuareve, dhe rrugëve dytësore.
- c. Operatori i shërbimit duhet të zbrazë, pastrojë vendin përreth dhe të mbajë pastër çdo ditë të gjithë koshat rrugorë brenda zonës së kontraktuar. Për këtë operojnë punëtorë dhe makina të veçanta. Shërbimi i zbrazjes dhe pastrimit të ambientit rreth tyre bëhet gjatë natës.
- d. Proçesit të fshirjes dhe pastrimit i nënshtrohen rrugët dhe trotuaret e parashikuara në zonën e kontraktuar (të asfaltuara, dhe trotuaret e qytetit).

5.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve

- a. Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora **21.00-05.00**.
- b. Për pastrimin e rrugëve Autoriteti kontraktor mund të ndryshojë dhe miratojë grafikun dhe oraret e shërbimit, pas kërkesës të njëjës palë, për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit. Këtu mund të përfshihen edhe rrugët brenda blloqeve të banimit apo rrugët dytësore që kanë lehtësi pastrimi gjatë ditës nga mungesa e parkimit.
- c. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në destinacione apo dhe në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.
- e. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.
- f. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

5.4 Rregulla për t'u zbatuar

- a. Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e Kontraktorit.
- b. Kontraktori detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.
- c. Për raste të veçanta Kontraktori është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.

- e. Gjatë procesit të fshirjes i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse, zonat e gjelbra, në banesat ujore natyrale apo artificiale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie Kontraktori detyrohet t'i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballet me penalitete sipas kësaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.
- g. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjopa për mosplotësim të tyre.

5.5 Mjetet dhe pajisjet

Kontraktori duhet të vërehet në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me krahe të rrugëve dhe trotuareve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

- a. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundur kryerjen me cilësi të shërbimit.
- b. Pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë.

6. Mirembajtja e VGM gjate dites dhe grumbullimi i mbetjeve ndertimore dhe te vellimshme.

6.1 Volumi i punimeve

Autoriteti kontraktor ka parashikuar shërbimin për të gjitha VGM e akseve kryesore dhe sipërfaqet e tyre përreth për të gjithë zonën e kontraktuar.

Kontraktuesi do të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha VGM e akseve kryesore të përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, nga ora 7.00 deri 15.00 me normativë deri në **50** pika grumbullimi për një punonjës.

Këto janë parashikuar për shërbimin e mirëmbajtjes dhe pastrimit gjatë ditës të VGM sipas grafikut miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

6.2 Specifikime teknike dhe metodologjia.

Shërbim i mirëmbajtjes dhe pastrimit të VGM të akseve kryesore, konsiston në:

a. Mirëmbajtjen dhe pastrimin me punëtorë gjatë ditës të VGM, duke mbledhur dhe larguar të gjitha mbetjet e vogla dhe të mëdha të hedhura në sipërfaqet përreth tyre, si rezultat i aktivitetit tregtar dhe të këmbësorëve.

b. Në rastet e evidentimit të një problematike të tillë, lajmërohet Kontraktuesi, i cili mbrenda 1 ore duhet ta eliminojë problemin. Në të kundërt, penalizohet.

6.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve

a. Mirëmbajtja dhe pastrimi i VGM do të bëhet gjatë ditës nga ora 09.00 deri 17.00 me kater punonjës dhe nje kamioncine.

b. Mirëmbajtja dhe pastrimi i VGM do të kryhet sipas grafikëve të hartuara nga sipërmarrësi dhe të miratuar nga Autoriteti kontraktor, me qëllim që gjatë gjithë ditës VGM e përcaktuar për shërbim të jenë krejtësisht e pastër ose duke u pastruar.

c. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga Kontraktori. Kontraktori nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

d. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

6.4 Rregulla për tu zbatuar

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen VGM të papastruara apo të mbushura me mbeturina . Në të gjitha rastet kur evidentohen raste të tilla, VGM e papastruar , lajmërohet Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet menjëherë të marrë masa për pastrimin e tyre brenda 1 orë nga njohja e problemit.. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit.

b. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të këtij shërbimi.

c. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjoba për mosplotësim të tyre.

6.5 Mjetet dhe pajisjet

1. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit

2-Makinë vetëshkarkuese e hapura nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, shërben për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj.

7. Larja e rrugëve me makinë teknologjike naten

7.1 Larje me solucion dhe me presion

Specifikimet teknike dhe metodologjia

Shërbimi i larjes me presion, me makineri teknologjike konsiston në:

a. Larjen me presion me makineri teknologjike larëse, si shërbim cdo nate.

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht rruget dhe sipërfaqet e tyre që do të lahen me presion dhe solucione nga 05:00 deri ne 07:00 të mëngjesit sipas grafikut të përcaktuar .

b. Operatori i shërbimit do të bëjë larjen me presion të rrugeve me makinë teknologjike, si shërbim cdo nate për tete muaj, në një sipërfaqe të përgjithshme prej **28 068 m²/nate** .

c. Larja e rrugëve, sipas grafikut të miratuar nga Autoriteti Kontraktor gjithmonë mbas shërbimit të pastrimit (fshirjes) të rrugëve, nga ora 05.00-07.00.

d. Larja me presion, me makinë teknologjike do të kryhet me grafikë të miratuar nga Autoriteti kontraktor, me qëllim që në orën 07.00 të jetë krejtësisht e larë.

e. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimeve të larjes, përgatiten nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.

f. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga Kontraktuesi. Kontraktuesi nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

g. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërmbyshjen e tyre.

7.2 Rregulla për t'u zbatuar

a. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kontrollojë gjatë kryerjes së shërbimit dhe pas përfundimit të tij, respektimin e standarteve në presionin e ujit për larje si dhe duke kontrolluar herë pas here sasinë e ujit të përdorur për larjen e sipërfaqes së parashikuar. Në rastet kur evidentohet presion i pamjaftueshëm në larje apo sasi e vogël e ujit të përdorur, shërbimi i larjes do të konsiderohet i pavlefshëm.

b. Të gjitha shpenzimet për ujin, që do të përdoret për larje, do perballohen nga Kontraktuesi.

7.3 Mjetet dhe pajisjet për larjen e rrugëve

a. Operatori i shërbimit duhet të sigurojë për realizimin e larjes me presion të rrugëve sipas përcaktimeve të kontratës, të gjitha punimet, materialet, pajisjet si dhe lejet përkatëse.

b. Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion dhe të përdorë për plotësimin e detyrave kontraktuale të larjes së rrugëve këto mjete:

- Makina për larjen e rrugëve, (autobot) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 7-8 ton, jo më pak se **1 (një) copë**;

c. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.

d. Të gjitha makinat për larjen e rrugëve duhet të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë.

e. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.

f. Detyrimisht në të gjithë makinat duhet të shkruhet mesazhe për edukimin ambjental, numri i telefonit i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht.

8. Lagia e rrugëve me makinë teknologjike

8.1 Volumet e Punimeve

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht të gjitha rrugët dhe sheshet me sipërfaqet e tyre të cilave u kryhet procesi i fshirjes në menyre manuale, për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të bëjë lagien të rrugëve me makinë teknologjike, si shërbim për **10 muaj** të vitit, në një sipërfaqe të përgjithshme prej **28068** m², nje herë në ditë.

Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre sipas grafikeve për shërbimin e lagies me makineri .

8.2 Specifikimet teknike dhe metodologjia

Shërbimi i lagies, me makineri teknologjike konsiston në:

Lagien e rrugëve të fshira në menyra manuale, në mënyrë që të mbulojnë me shërbim lagie të gjitha sipërfaqet e plota të parashikuara në grafikët përkatës miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

8.3 Plani i Punës dhe grafikët e punimeve

a.Lagia e rrugëve, si shërbim 10 mujor, do të kryhet me grafikë të miratuar nga Autoriteti kontraktor.

b.Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimeve të lagies së rrugëve, përgatiten nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.

c.Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga Kontraktori. Kontraktori nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

d.Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

8.4 Rregulla për t'u zbatuar

a.Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kontrollojë gjatë kryerjes së shërbimit dhe pas përfundimit të tij, respektimin e standarteve në presionin e ujit për lagie si dhe duke kontrolluar herë pas here sasinë e ujit të përdorur për largien e sipërfaqes së parashikuar. Në

rastet kur evidentohet presion i pamjaftueshëm në lagje apo sasi e vogël e ujit të përdorur, shërbimi i lagjes do të konsiderohet i pavlefshëm.

b.Listat përkatëse të rrugëve që do lahen i bashkëngjiten kësaj kontrate.

c.Të gjitha shpenzimet për ujin, që do të përdoret për larje, do mbarten nga operatori i shërbimit.

d.Orari i shërbimit është 11:00 – 14:00 .

8.5 Mjetet dhe pajisjet për lagjen e rrugëve

a.Operatori i shërbimit duhet të sigurojë për realizimin e larjes me presion të rrugëve sipas përcaktimeve të kontratës, të gjitha punimet, materialet, pajisjet si dhe lejet përkatëse.

b.Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion dhe të përdorë për plotësimin e detyrave kontraktuale të larjes së rrugëve këto mjete:

- Makina për larjen e rrugëve, (autobot) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 7-8 ton, jo më pak se **1 (një) copë**;

c.Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.

d.Të gjitha makinat për larjen e rrugëve duhet të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë.

e.Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.

f.Detyrimisht në të gjithë makinat duhet të shkruhet mesazhe për edukimin ambjental, numri i telefonit i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht.

9. “Edukimi Publik Mjedisor”

a.Në termin “Edukim Publik”, do të nënkuptohet aktiviteti publicitar i Kontraktorit për të rritur dhe përmirësuar njohuritë e konsumatorit përsa i përket mbledhjes, përpunimit dhe largimit të mbetjeve, ndarjes së mbetjeve në burim, etj periudhës së kontratës.

b.Kontraktori duhet të krijojë një kontakt të vazhdueshëm me komunitetin e zonës i cili luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në mbarëvajtjen e punës së Kontraktorit por edhe në minimizimin e ndotjes së ambjentit.

c.Kontraktori duhet të mundësojë shpërndarjen e materialeve informative një herë në 3-muaj. Materialet informative duhet të jenë në formën, fletëpalosjeve si dhe broshurave duke përfshirë në to informacione mbi shkaqet dhe shkaktarët e kësaj ndotje, parandalimin e saj si dhe masat që mund të merren për minimizimin e ndotjes. Materialet sensibilizuese duhet të jenë të tilla që të ftojnë banoret për tu bërë pjesë aktive e një shoqërie të emancipuar dhe me një edukatë mjedisore.

d.Kontraktori duhet të sensibilizojë banorët nëpërmjet programit të edukimit publik mjedisor që të parkohet në përputhje me planin e ndryshimit të parkimit, në rrugë dhe ditë të caktuara, për të mundësuar fshirjen më me cilësi të këtyre rrugëve.

e. Programi i edukimit mjedisor që do të bëjë operatori i shërbimit duhet të miratohet nga Autoriteti kontratues. Operatori i shërbimit duhet të paraqitet me preventiv brënda zërit të parashikuar për tu miratuar nga autoriteti kontraktues.

f. Buxheti që Sipermarresi duhet të shpenzojë për edukimin mjedisor, është i përfshirë në koston e zërit të shërbimit “Grumbullim, transport i mbetjeve urbane” (sipas llogaritjes së kostos në bazë të VKM). Në rast mos realizimi i zbritet në situacion pagesa në zërin “grumbullim dhe transport i mbetjeve urbane”

10. Pajisja e punonjësve me uniformë.

a- Kontraktori duhet të pajisë të gjithë punonjësit e vetë me uniforme të njëjta.

b- Uniforma duhet të ketë të stampuar siglën e Kontraktuesit, si dhe të Autoritetit Kontraktor. Kjo në dakortësi ndërmjet palëve.

c- Punonjësit duhet të pajisen me uniforme verore dhe dimërore, model i miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

d- Mbrenda tre muajve të fillimit të kontratës, të gjithë punonjësit duhet të jenë të pajisur me uniformën.

e- Nuk lejohet për asnjë lloj arsye që punonjësit të mos kenë të veshur uniformën e përcaktuar, në të kundërt, penalizohet.